

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

2

Kosovë - Mars 2007

Botimi për Kosovë "Konflikti dhe Zhvillimi"

Parathënie

Frode Mauring

Përfaqësues i UNDP-së

Konflikti dëmton zhvillimin e veçanërisht zhvillimin njerëzor. Sipas *Raportit Botëror të Zhvillimit Njerëzor*, tetë nga dhjetë vendet me nivelin më të ulët të zhvillimit njerëzor kanë përjetuar konfliktin gjatë dy dekadave të fundit. Dikush mund të thotë se mungesa e zhvillimit (dhe veçanërisht zhvillimi jo i barabartë) shpie në konflikt sepse në shoqëri disa përfitojnë e disa jo, dhe kjo është e vërtetë. Pa u ndalur më shumë në shkaqet, tashmë është dokumentuar mjaft mirë se konflikti dhe zhvillimi zakonisht nuk shkojnë njëri me tjetrin. Prandaj, qëllimi parësor i akterëve të zhvillimit duhet të jetë trajtimi i shkaqeve të konfliktit në mënyrë që të nxisin zhvillimin. Përvoja botërore poashtu tregon se sa më i lartë që të jetë koeficienti Gini¹ aq më e madhe do të jetë mundësia që të ketë konflikt brenda një vendi. Kur konflikti lokalizohet ose kontrollohet (siç është rasti në Kosovë), akterët ndërkombëtarë dhe vet Qeveria duhet të sigurojnë zhvillimin e vendit, veçanërisht duke punuar në politikat dhe kushtet të cilat do të sigurojnë se përfitimet nga zhvillimi do të shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe së ai zhvillim do të ketë si objektiv ata që janë në pozitën më të pafavorshme. Kjo do të parandalojë kthimin në rrethin e mbullur të konfliktit dhe varfërisë ose moszhvillimit. Gjetja e një zhvillimi të ekuilibruar është e vështirë por e domosdoshme për parandalimin e konfliktit.

Për momentin Kosova gjendet në një fazë të tranzicionit politik, ekonomik dhe social. Ndonëse Kosova vazhdon të mbetet nën administrimin formal të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) siç përcaktohet në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244, është arritur progres në bartjen e

përgjegjësi nga administrata e OKB-së te Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ). Për këtë qëllim, institucionet vendore të Kosovës kanë forcuar dhe po vazhdojnë të forcojnë aftësitë e tyre operacionale, gjë që është demonstruar me hartimin e Kornizës Kushtetuese dhe me mbajtjen e suksesshme të dy zgjedhjeve të përgjithshme dhe dy zgjedhjeve komunale që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999.

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme, gjendja e pasigurtë e sigurisë në Kosovë (si reale ashtu edhe e perceptuar), shqetësimet rreth lirisë së lëvizjes, mundësitë e kufizuara ekonomike, qasja e kufizuar e komuniteteve pakicë në shërbime publike dhe në përgjithësi gjendja e pasigurtë politike mbetet e pranishme në Kosovë. Në të njëjtën kohë, Kosova ende është vendi më i ndarë në Evropë. Ndërtimi i paqes dhe zhvillimi do të bëjnë shumë pak përderisa të ketë enklava të mbrojtura dhe qytete të ndara brenda territorit të saj. Nëse Kosova dëshiron të tejkalojë të kaluarën e konfliktit, varfërisë dhe dobësisë institucionale është shumë e rëndësishme që të vazhdojë zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë, promovimin e një shoqërie civile dhe të një ekonomie të tregut të hapur.

Në fund, populli i Kosovës duhet të zgjidh vet problemet e veta, bashkë me fqinjët e tij. Bashkësia ndërkombëtare mund të ofrojë kornizën për një Kosovë në paqe por u takon qytetarëve të Kosovës që atë ta bëjnë realitet. Për një kohë të gjatë populli i Kosovës ka drejtuar sytë kah fuqitë e jashtme që tua zgjidhin problemet, ose për fatkeqësitë e tyre i kanë fajësuar ndikimet keqdashëse nga jashtë. Me sqarimin e çështjes së statusit do të fillojë një fazë e re ku do të sqarohen përgjegjësitë dhe ku do të fillojë demokracia e vërtetë, e cila është një parakusht për të mundësuar zhvillimin dhe besimin për parandalimin e kthimit drejt konfliktit. Kosovarët, si ata që jetojnë në Kosovë ashtu edhe ata që jetojnë jashtë, duhet të inkurajohen që të punojnë dhe investojnë në atdheun e tyre dhe

Përmbajtja

Rishikimi i sektorit të sigurisë së Kosovës	Lundrim Aliu.....2
Propozimi i Ahtisarit dhe e ardhmja e sektorit të sigurisë së Kosovës	Jérôme Mellon.....3
Parashikim për një nivel të ri të qeverisjes në Kosovë	Admir Duraj.....5
Gjetja e zgjedhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova	Pleurat Halili.....7
Zhvillimi Lokal për Stabilizimin e Komuniteteve në Mitrovicë dhe Zveçan, Kosovë	Dr. Ricardo Pinto.....8
Harmonizimi i Legjislaturës me Acquis Communautaire dhe Kosova	Av. Jordan DACI, ...11
Kosova, Procesi i statusit përfundimtar dhe sfidat e zhvillimit	Dardan Velija12

1 Koeficienti i Gjinit është masa e pabarazisë së shpërndarjes. Përcaktohet si raport mes vlerës 0 dhe 1: numëruesi është fusha mes lakorës së Lorencit të shpërndarjes dhe të linjës uniforme (të përkryer) të shpërndarjes; emëruesi është fusha nën vijën uniforme të shpërndarjes.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

që ta bëjnë vendin e tyre të mirë për të jetuar tani dhe për të ëndërruar të ardhmen – të dy këto komponente shumë të rëndësishme të shpresës dhe zhvillimit.

Rishikimi i sektorit të sigurisë së Kosovës

Lundrim Aliu

Zyrtar vendor për çështje politike i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në kuadër të Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK). (Deri në janar, Lundrim Aliu ishte konsultant për komunikime me publikun, Konsultat për Rishikimin e Sektorit për Siguri të Brendshme (RSSB)).

Vitet që kaluan prej ndërhyrjes ushtarake dhe humanitare në Kosovë në vitin 1999, kanë treguar një konsensus gjithnjë në rritje të bashkësisë ndërkombëtare zhvillimore se siguria është nevojë themelore njerëzore dhe parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm. Zgjidhja e statusit të ardhshëm të Kosovës, ku përgjegjësi të dukshme rreth sigurisë mund të kalojnë prej institucioneve ndërkombëtare në ato vendore, nënvizon nevojën për rishikimin e ofrimit të sigurisë në Kosovë. Një rishikim² i tillë: Është bërë për herë të parë në Kosovë në vitin 2006 nën patronatin e UNDP-së;³ Është bërë në bazë të metodologjisë së rekomanduar nga Ekipi këshillëdhënës për zhvillimin e sektorit të sigurisë⁴; Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme (RSSB) është kryer në 8 faza, ku secila prej tyre ka ndikuar në rekomandimet përfundimtare të raportit. Fazat 1 dhe 2 kanë paraqitur analizën e kërcënimeve, ndërsa në fazat 3 dhe 4 është bërë një analizë e thukët e institucioneve të Kosovës të ndërlydhura me sigurinë, si dhe janë bërë konsultime të gjëra dhe një fushatë e kontaktimit me qytetarë. Fazat 5 dhe 6 i identifikuan mangësitë në trajtimin e kërcënimeve ndaj sigurisë. Faza 7 i shqyrtoj kërkesat buxhetore dhe përmes fazës 8 u dhanë strategjitë e përgjithshme për përmirësimin e kërcënimeve të identifikuar.

Kontributet për identifikimin e kërcënimeve të perceptuara të sigurisë erdhën nga disa burime. Kontributet janë marrë nga mbarë Kosova nëpër takimet në kuvendet komunale, ku morën pjesë mbi 800 persona. Kosovarët kanë mundur t'i japin kontributet e veta edhe përmes tel-

efonit, postës elektronike apo postës. Përveç kësaj, ekipi hulumtues i RSSB-së i bëri më shumë se 70 intervista me zyrtarët vendorë dhe ndërkombëtarë. Po ashtu e bëri një rishikim të thukët të dokumenteve, ku u përfshinë raportet institucionale ndërkombëtare dhe vendore dhe dokumentet zyrtare. Qeverisja institucionale është analizuar në bazë të metodologjisë së UNDP-së dhe të Bankës Botërore, ndërsa zhvillimi është analizuar në bazë të metodologjisë së OECD-së. Kriteret e Kopenhagës së BE-së përkitazi me hyrjen në BE shërbyen si standard i përgjithshëm politik.

Rishikimi po ashtu u përqendrua në çështjet, siç është ajo e kompanive private të sigurimit, e armëve të vogla dhe të lehta, e gjinisë dhe e lirisë së lëvizjes. Një pjesë e madhe e punës është bërë nga një ekip i vogël i RSSB-së i përbërë nga ekspertët ndërkombëtarë dhe vendorë në kuadër të Zyrës së kryeministrit. Ekipi është përkrahur nga Instituti i Kosovës për Hulumtime dhe Zhvillim, Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Përmes rishikimit⁵ u erdh në përfundim se përderisa mjedisi i sigurisë në Kosovë është përmirësuar dukshëm që nga ndërhyrja e NATO-s më 1999, ky mjedis gjithashtu është bërë më i ndërlikuar. Papunësia e lartë dhe çështjet e zhvillimit ekonomik (duke përfshirë infrastrukturën dhe qasjen në rrymën elektrike) janë burimet kryesore të pasigurisë për popullin e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Çështjet e dhunës etnike, korrupsionit dhe të krimit shpesh lidhen me këto probleme ekonomike. Rishikimi theksoi nevojën për përmirësimin e sistemit të arsimit dhe atij të shëndetësisë, për avancimin e zhvillimit ekonomik, si dhe konkludoi se gjyqësori, që konsiderohet nga shumica e njerëzve si joefikas, jo i aftë apo jo i pavarur sa duhet, është burim i mosbesimit në rritje ndaj institucioneve dhe udhëheqësve politikë. Lidhur me kërcënimet e jashtme, Kosova ballafaqohet me kërcënimin e krimit të organizuar dhe me ripërtëritjen e mundshme të dhunës politike. Studimi vjen në përfundim se marrëdhëniet e Kosovës me fqinjët e saj – me Serbinë në veçanti – nuk janë stabile dhe kërkojnë vëmendje të mëtejme nga Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare, e cila e administron dhe e mbikëqyrë Kosovën.

² Shih ISSR, <http://www.issrkosovo.org>.

³ Shih UNDP, <http://www.kosovo.undp.org/?cid=2,3&argroup=6>.

⁴ Shih UK Ministry of Defence <http://www.mod.uk/DefenceInternet/AboutDefence/WhatWeDo/SecurityandIntelligence/>

EKZHSS/. Rishikimi është mbikëqyrur nga Komisioni ku kanë qenë të përfaqësuar Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Institucionet e përkohshme të Vetëqeverisjes

⁵ Cleland Welch, A.; Kondi, S.; Stinson, D.; Von Tangen Page M; (eds) 2006. Internal

Edhe pse këto gjetje nuk janë drejtpërdrejtë të lidhura me statusin e Kosovës, ato kanë disa implikime të rëndësishme për të ardhmen e saj. Përmes raportit rekomandohet krijimi i institucioneve të reja të sigurisë, siç është Këshilli i Sigurisë i Kosovës me kompetenca ekzekutive, Ministria e Mbrojtjes, dhe Shërbimi i Sigurisë – nëse Kosova e merr përgjegjësinë për institucionet e veta të sigurisë pas zgjidhjes së statusit të saj. Po ashtu, raporti rekomandon përfshirjen e fuqishme ndërkombëtare, kryesisht të NATO-s, në ndërtimin e strukturave të reja të sigurisë.

Rishikimi ishte instrument i dobishëm në analizën e nevojave për zhvillimin institucional në sektorin e sigurisë dhe në tërheqjen e vëmendjes për nivelin e sfidave të sigurisë së njerëzve në Kosovë. Pasi që në Kosovë strukturat e brendshme shtetërore të sigurisë ende nuk janë zhvilluar, përveç disa funksioneve policore dhe të gjyqësorit, gjetjet e raportit mund të ndihmojnë në parandalimin e problemeve të sektorit të sigurisë kur këto institucione të themelohen dhe të bëhen funksionale. Rishikimi i sektorit të sigurisë së Kosovës mund gjithashtu të shërbejë si model për rishikimet në vendet e tjera paskonfliktuale, në veçanti në ato ku do të bëhen përpjekje nga institucionet ndërkombëtare apo angazhimet për ndërtimin e shtetit.

Propozimi i Ahtisarit dhe e ardhmja e sektorit të sigurisë së Kosovës

Jérôme Mellon

Koordinator, Ekipi i Evropës Juglindore, Project Saferworld

Pas më shumë se shtatë vjet pritjeje, zgjidhja e statusit të ardhshëm të Kosovës është shumë afër. Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (më tutje në tekst Propozimi) i përgatitur nga Marti Ahtisari (Martti Ahtisaari) është shpallur para qeverisë së Serbisë dhe asaj të Kosovës më 2 shkurt 2007. Edhe pse nuk është tekst përfundimtar, ky dokument 58 faqesh jep bazën më të qartë deri më tani për atë sesi do të duket statusi përfundimtar i Kosovës.

Përkundër mbulimit të gjerë të propozimit nga ana e mediave, deri më tani janë publikuar shumë pak analiza mbi rekomandimet dhe ndikimin e tij.⁶ Ky artikull paraqet disa

nga çështjet dhe sfidat lidhur me rekomandimet kryesore të paraqitura në shtojcën VIII të Propozimit që ka të bëjë me sektorin e sigurisë së Kosovës.

Policia dhe komunitetet

Përmes Propozimit rekomandohet që “Këshillat lokale të përbërë nga përfaqësuesit komunalë dhe të policisë, duke përfshirë komandantët e stacionit, do të bëhen plotësisht funksional me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit mes Shërbimit Policor dhe autoriteteve komunale dhe udhëheqësve të komunitetit.”⁷

Shumë punë pozitive janë ndërmarrë në fushën e policisë së komunitetit, kryesisht përmes përkrahjes së OSBE-së për ekipet e veprimit për sigurinë e komuniteteve, për Këshillat Lokale për Siguri Publike (KLSP) dhe nga grupi udhëheqës i Kosovës për policinë e bazuar në komunitet. Prania e ardhshme ndërkombëtare civile duhet të zhvillojë këtë punë edhe më tej, duke u përqendruar në kontaktet me qytetarët dhe duke përmirësuar qasjen e komuniteteve të ofruesit të sigurisë përmes forumeve formale dhe joformale. Për më tepër, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ) duhet të shqyrtojnë mundësinë e përfshirjes së strukturave të formalizuara, siç janë KLSP-të në Projektligjin e tyre për policinë dhe të hartimit të strategjisë mbarëkosovare për policinë e komunitetit.

Propozimi gjithashtu rekomandon se në “komunat me shumicë serbe, komandantët lokalë të stacioneve do të zgjedhen në bazë të një procedure të [posaçme],”⁸ ndryshe nga ajo e përdorur në komunat e tjera. Pavarësisht sesa të mira janë qëllimet e këtyre rekomandimeve, këto vazhdojnë modelin fatkeq të qasjeve që i fuqizojnë ndasitë etnike në Kosovë në vend që t’i bashkojnë komunitetet e ndryshme përmes qasjeve të përbashkëta dhe ndarjes së shqetësimeve.

Duke marrë parasysh realitetin praktik dhe kufizimet kohore, këto qasje duhet të jenë të përkohshme dhe vetëm në raste të veçanta. Nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike në Kosovë mund të jenë të ndryshme, por masat specifike të natyrës etnike duhet të

⁶ Disa mendime dhe analiza ekzistuese janë paraqitur nga Instituti Kosovar për Hulumtime të Politikave dhe Zhvillim, Analiza e pakos gjithëpërfshirëse për statusin e Kosovës, (KIPRED, shkurt 2007), Dérens J-A, Statut du Kosovo: revoyez votre copie, M. Ahtisaari!, (Le Courrier des Balkans, 7 shkurt 2007), dhe të organizatës për demokraci, kundër korrupsionit dhe për dinjitet, Analiza e pakos së Ahtisarit (Çohu!, shkurt 2007).

⁷ Ahtisaari M, Propozimi gjithëpërfshirës për marrëveshjen mbi statusin e Kosovës, (UNOSEK, 2 shkurt 2007), faqe 47.

⁸ Ahtisaari M, po aty, faqe 47.

⁹ Ahtisaari M, po aty, faqe 11.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

minimizohen për të zhvilluar shoqërinë “shumetnike të bazuar në barazinë e të gjithë qytetarëve dhe në nivelin më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht”, të cilat kërkohen edhe në Propozim⁹.

Plotësimi i nevojave për shërbim të sigurisë të Kosovës

Në Propozim rekomandohet që Kosova “të themelojë agjencinë vendore të sigurisë për monitorimin e kërcënimeve ndaj sigurisë së brendshme të Kosovës”, duke shtuar se “kjo agjenci do të jetë profesionale, jopolitike, shumetnike dhe se do të mbikëqyret nga Kuvendi, si dhe do të administrohet nga administrata civile.”¹⁰

Megjithatë, shumë kosovarë i perceptojnë shërbimet informative si instrumente represive të shtetit. Andaj, pikësëpari Kosova duhet të hapë një debat të hapur dhe të sinqertë publik për ta demistifikuar rolin dhe aktivitetin e shërbimit të sigurisë së Kosovës dhe për të avancuar një kulturë politike, ku politikëbërja është në funksion të shqetësimeve të popullatës. Pa një debat të tillë, shpresat se kosovarët se do t’i përqafojnë konceptet moderne të sigurisë dhe të shërbimeve informative, si dhe t’i mbështesin përpjekjet për sigurimin e funksionimit të duhur të shërbimit të ri në përputhje me normat demokratike do të jenë të vogla.¹¹

Shërbimi i ri informativ i Kosovës, duhet të jetë plotësisht vendor dhe të ketë për qëllim “ofrimin këshillave në kohë të duhur, që janë relevante, të sakta dhe parashikuese [...] për marrjen e vendimeve në bazë të informatave për të mirën e popullatës së Kosovës dhe të fqinjëve të saj.”¹² Për sa kohë që interesat e jashtme dhe prania e Kosovës jashtë mbetet e kufizuar – që parashihet të jetë gjatë një të ardhmeje të afërt – nuk do të ketë nevojë urgjente për një shërbim informativ të zbulimit të jashtëm.

Me siguri qëllimisht, Propozimi nuk e trajton ekzistimin e shërbimeve jozyrtare informative, siç është Instituti për Hulumtime Strategjike të Opinioneve Publik dhe Shërbimi Informativ i Kosovës, të cilat thuhet se janë të lidhura me partitë politike dhe që punojnë ngjashëm me shërbimet

zyrtare informative. Politikëbërësit duhet të vendosin se çka duhet të bëhet me këto organizata jozyrtare; nëse ato do të duhej shpërbërë? A do të mund të lejoheshin pjesëtarët e tyre t’i bashkohen Shërbimit të ri të Sigurisë së Kosovës?¹³ Çka duhet të bëhet me informatat dhe me dosjet e grumbulluara nga këto organizata gjatë viteve të kaluara? Të gjitha këto janë pyetje të ndjeshme, por pa i trajtuar ato, shpresat janë të vogla që Kosova do të krijojë një shërbim informativ transparent, të efektshëm dhe efektiv që i përgjigjet nevojave të qytetarëve të Kosovës.

Shpërbërja e TMK-së dhe krijimi i FSK-së

Në një nga rekomandimet me kundërthënëse është se Propozimi sugjeron që “TMK-ja [Trupat Mbrojtëse të Kosovës] do të shpërbëhet [...] brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje” dhe se “një Forcë Sigurisë së Kosovës (FSK) e re dhe shumetnike do të themelohet [...] FSK-ja do të jetë e armatosur lehtë dhe nuk do të ketë aratim të rendë, siç janë tanket, artileria e rendë apo force ajrore sulmuese. FSK-ja duhet të përbëhet nga jo më shumë se 2,500 pjesëtarë aktive dhe 800 pjesëtarë rezervë.”¹⁴

Në Propozim konsiderohet se TMK-ja tanimë i “ka plotësuar qëllimet e veta, duke përfshirë lehtësimin e rimëkëmbjes së Kosovës pas konfliktit”¹⁵, edhe pse nuk shpjegohet në cilat kritere është bazuar një përfundim i tillë. Por aspekti më i ndjeshëm dhe kundërthënës i këtij rekomandimi është fati që i pret pjesëtarët e TMK-së që do të detyrohen të dalin në pension.

TMK-ja që ka lindur më 1999 nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës që ishte shpërbërë dhe përbëhet prej 3,052 pjesëtarëve aktivë dhe 2.000 rezervistëve. Shpërbërja e saj do t’i lë ish-pjesëtarët e vet pa punë, pa paga dhe pa prestigj. Për më tepër, gjasat janë të vogla se KSF-ja e paraparë do të jetë e interesuar apo e aftë për të absorbuar më shumë se 500 ish-pjesëtarë të ish-TMK-së, duke i lënë kështu së paku 2.500 burra me përvojë luftarake pa punë. Duke marrë parasysh respektin për TMK-në që e kanë shqiptarët e Kosovës dhe vazhdimin e ndikimit të ish-pjesëtarëve të UÇK-së në shoqërinë e Kosovës, demobilizimi, risistemimi dhe pensionimi i këtyre ish-pjesë-

¹⁰ Ahtisaari M, po aty, faqe 48. Propozimi cek se Përfaqësuesi ndërkombëtar Civil “mbikëqyrë zhvillimin e agjencisë vendore të sigurisë (faqe 52) dhe gjithashtu rekomandon miratimin, gjatë periudhës 120 ditore apo menjëherë pas saj, të Ligjit për themelimin e agjencisë vendore informative të Kosovës” (faqe 58).

¹¹ Mellon J, Ishërbimi informativ në Kosovë: Duke shikuar përpara, (FIQ dhe Saferworld, mars 2007), faqe 17.

¹² Mellon J, po aty, faqe 12.

¹³ Raporti i Rishikimit të Sektorit për Siguri të Brendshme (RSSB) rekomandon që “disa anëtarë të strukturave paralele mund të lejohen t’i bashkohen institucionit të ri të sigurisë pas procesit të verifikimit të qartë dhe transparent që përfshinë kriterin e kompetencës,” e cila është ndoshta qasja më realiste ndaj kësaj çështjeje të ndjeshme. Shih Cleland-Welch A et al, Rishikimi i Sektorit të Brendshëm të Sigurisë së Kosovës, (UNDP, 2006), faqe 150.

¹⁴ Ahtisaari M, op. cit. vërejtje 2, faqe 49.

¹⁵ Ahtisaari M, po aty, faqe 6. Admirali Harry Ulrich, komandant i komandës së bashkuar të NATO-s në Napoli, dha një koment më 24 shkurt 2007 se “shpërbërja e TMK-së është hap i nevojshëm në zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës – një institucion që do ta çon Kosovën në të ardhmen.”

tarëve të TMK-së duhet të bëhet me takt, me kujdes dhe me planifikim shumë të hollësishëm.

Sugjerimi për të krijuar FSK-në është një nga më të guximshmit të Propozimit, me një potencial të madh për pasojat negative përkitazi me pajtimin mes shqiptarëve të Kosovës dhe të komuniteteve të tjera pakicë në Kosovë, si dhe me marrëdhëniet e Kosovës me fqinjët saj, me Serbinë ë veçanti. Themelimi i FSK-së duhet të lidhet me një program të kujdesshëm të informimit publik dhe me kontakte me qytetarët në nivel regional për të parandaluar keqinterpretimet e mundshme apo tensionet e ripërtëritura dhe për të krijuar marrëdhënie pozitive që nga fillimi.

Fatqësisht ka pak kohë për konsultimet publike për këto dhe aspekte të tjera të propozimit para se Këshilli i Sigurimit të OKB-së të debatohet dhe të miratohet rezolutën e re për Kosovë. Zyra ndërkombëtare Civile pasuese dhe Prania Ndërkombëtare Ushtarake duhet të organizojnë këtë fushatë të kontaktimit me qytetarë urgjentisht, veçanërisht duke marrë parasysh rolin e tyre qendror në fushën e ndjeshme të sigurisë. Për më tepër, IPVQ-të e Kosovës duhet – edhe pse me vonësë – të angazhohen me shoqërinë civile dhe me popullatën në përgjithësi për të debatuar dhe shpjeguar opsionet për institucionet e sigurisë së Kosovës.

Parashikim për një nivel të ri të qeverisjes në Kosovë

Admir Duraj

Këshilltar, Zyra për Integritet Evropian, Ministria e Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit

Qui non est hodie cras minus aptus erit¹⁶. Ovid

Përderisa dyshoj se origjina e kësaj është e mbyllur diku thellë në kujtesën shkollore që orvatet mes studimeve të drejtësisë dhe politikës, ky shënim filloi të marrë formë të dukshme gjatë një fluturimi nga Lubjana për në Prishtinë javën e kaluar pas një Forumi shumë interesant në Bled mbi Evropën që këtë vit kishte për temë: 'Qeverisjen e së ardhmes'.

Kjo temë duket të jetë e përhapur kudo, pavarësisht se a kanë të bëjnë vendimet e juaja vetëm me ju dhe/ose me njerëzit rreth jush, ose nëse jeni duke ecur, marrë frymë,

kërkuar dimensione të reja, punë, vijën e parë në shoqëritë transitive ose moderne, ose jeni duke fluturuar mbi ish-Jugosllavi. Nuk kisha si të mos vërej disa përfundime që veçse ishin artikuluar në mendjen time prej kohësh. Kam qenë në Prishtinë që nga shtatori i vitit 2005 duke punuar në një projekt për të Ndihtuar Ngritjen e Kapaciteteve. Puna që ngërthente në vete të qenit këshilltar në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) është mjaft sfiduese. Çdokush në atë pozitë mund të kuptojë se objektivat e caktuara sipas një intervenimi të caktuar zhvillimor mund të jenë të prira të përballen me një shkallë të lartë të nevojës, por po ashtu edhe të pengesave në mjedisin në fjalë.

Procesi i ngritjes së kapaciteteve në institucione me qëllim të arritjes së qeverisjes pjesëmarrëse është ngushtë i lidhur, por jo i kufizuar, me njohuritë dhe shkathtësitë e individëve. Në një shkallë më të gjerë ndërtimi i kapaciteteve varet nga cilësia e organizimit dhe strukturës. Ngritja e kapaciteteve është sfidë. Një proces i suksesshëm për IPVQ-të e Kosovës në këtë aspekt është i rëndësishëm për besueshmërinë dhe legjitimitetin e qeverisë. Po ashtu është qenësor për arritjen e qëllimeve të qeverisë përveç përbushjes së zotimeve për të implementuar standardet e caktuara nga bashkësia ndërkombëtare si pjesë e procesit për përcaktimin e statusit. Në disa dokumente strategjike dhe të politikave tregohet se qeveria e Kosovës dhe bashkësia e donatorëve ndërkombëtarë kanë caktuar standardet sfiduese për procesin e Ngritjes së Kapaciteteve.

Përvoja, si nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, tregon se procesi i ndërtimit të institucioneve dhe trajnimit i kuadrove të tyre të caktuara është i gjatë, kompleks dhe i vështirë. Çdo mundësi për sukses varet nga gjashtë elemente të domosdoshme që duhet të sigurohen: i) udhëheqje e fuqishme politike vendore; ii) përqendrim në rezultatet e fundit; iii) disa masa të "kërkesave" nga qytetarët; iv) një proces të ndryshimeve institucionale; v) sjellje e përshtatshme dhe e bashkërenduar e donatorëve; dhe vi) kornizë dhe pritje realiste.

Këto komente përmbyllëse, të përsëritura pas një viti në Kosovë me Ndihtim për Ngritje të Kapaciteteve marrin një qëndrim vet-pasqyruar mbi institucionet e vetëqeverisjes të cilat ne nuk mund t'i konsiderojmë 'të përkohshme' përgjithmonë. Andaj, diskursi mbi qeverisjen, të ardhmen, objektivat, institucionet efikase dhe politikatat publike siç janë vënë në pah nga Forumi i Bledit mbi Evropën në vitin 2007.

¹⁶ Lat. 'Kush nuk është i përgatitur sot do të jetë edhe më pak i përgatitur nesër.'

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

Në Evropën e sotme një proces i ri i vizionit për ndërtim sistematik, pjesëmarrës, mbledhjen e informacioneve në të ardhmen dhe që është afatmesëm deri te afatgjatë që synon vendimet tani dhe mobilizimin e veprimeve të përbashkëta në të ardhmen është zhvilluar. I quajtur 'Parashikim' ky instrument kërkon përkushtim, përqendrim, dinamikë dhe vizion për të menduar, debatuar dhe formësuar të ardhmen. Duke u angazhuar si duhet me proceset që ngritën mbi parimet e demokracisë përfaqësuese disa trende të tashme duhet të shqyrtohen kur kryejmë intervenime efikase për zhvillim të kapaciteteve dhe të arritur institucione të qëndrueshme dhe korniza të politikave. Mund të tingëllojë si një vështrim i kufizuar, por në aspektin praktik këto trende të caktuara duken të jenë të humbura kur kërkojmë të vlerësojmë punën e strukturës së tashme institucionale.

Informacionet: Çfarë shtrirje, sasie, cilësie e informacioneve arrin te qytetarët?

A ekziston ndonjë konsultim ose ndonjë mundësi tjetër për qytetarët të ofrojnë komente, reagime ndaj vendimeve për politikat?

A mund të flasim rreth pjesëmarrjes aktive dhe përpjekjeve për të angazhuar qytetarët në vendimmarrje mbi baza të partneritetit sot në Kosovë?

Një pyetje kyçe për institucionet e të gjitha niveleve në Kosovë është se a është koha e duhur për t'i përmirësuar këto çështje? Me siguri se është.

Të mendohet e ardhmja

Për Kosovën, 'parashikimi' mund të shërbejë si pikë e mirë hyrëse në angazhimet civile dhe strukturale për qeverisje të qëndrueshme dhe pjesëmarrëse. Për të arritur këtë, parashikimet dhe vlerësimet e burimeve në dispozicion, hulumtim të politikave dhe identifikim të trendeve afatgjate dhe udhëzime për vendimmarrje janë të domosdoshme.

Të debatohet e ardhmja

Parashikimi është një proces pjesëmarrës që përfshin palë të ndryshme. Çfarë do të thotë kjo për Kosovën? Në thelb, kjo nënkupton kompleksitetin, llojllojshmërinë dhe kulturë të gjerë. Mund të përfshijë autoritetet publike, biznesin, organizatat hulumtuese, organizatat jo-qeveritare e kështu me radhë, por duhet të mos përjashtojë grupet e marginalizuara, fetare dhe etnike, përderisa përpiqemi të arrijmë barazinë gjinore, dhe të rrisim kohezionin shoqëror. Procesi mund të organizohet nga niveli komunal te nivelet qendrore të ngritura rreth një agjende konstruktive, e cila më pastaj mbulon prioritetet konsensuale. Përfitimet nga debati ndihmojnë zhvillimin e zgjidhjeve

të ndryshme dhe/ose skenarëve mbi nevojat dhe trendet me të cilat tashmë përballet shoqëria. Në këtë pikë, institucionet akademike, qendrat hulumtuese dhe lëvizjet e qytetarëve në përgjithësi duhet të marrin rolin prijës.

Të formësohet e ardhmja

Kur e diskutojmë të ardhmen, hapi i parë është të zhvillojmë disa tregues që na ndihmojnë në ndërtimin e një pasqyre sa më të qartë se çfarë do të jetë e ardhmja. Deri në këtë masë vizioni është një produkt i Parashikimit me që synon identifikimin e të ardhmeve të mundshme, duke imagjinuar ato të dëshirueshmet dhe duke përcaktuar strategjitë për të arritur atje. Rezultatet duhet të futen në vendimmarrjen publike por ato po ashtu ndihmojnë palët të zhvillojnë ose të përshtatin strategjitë e tyre. Debatimi i tashëm në Kosovë, siç paraqitet përmes medieve vendore dhe ndërkombëtare, qartazi pasqyron përqendrimin në 'negociatat mbi statusin'. Ky lajm mund të tingëllojë si mjaft i vjetruar pas disa ditësh, përderisa në po futemi në zhvillime të reja: e ardhmja e mundshme kundër të ardhmes së dëshirueshme. Kjo mund të jetë e misterhme, por lojtarët që duhet ta zgjidhin këtë njihen si vendimmarrës, hartues të politikave dhe si votues, do të thotë, qytetarët pa dallim feje, gjinie, nacionaliteti ose origjine etnike, besimeve dhe përkatësisë politike.

Të menduarit, debatuarit dhe të formësuarit e të ardhmes janë edhe më të rëndësishme sot për shkak të kompleksitetit të shkencës, teknologjisë dhe marrëdhënieve shoqërore. Por, të kuptuarit e kontekstit të Kosovës mbetet një imperativ, që do të sillte çështje të reja kritike në agjendën politike përderisa orvatemi të ndërtojmë të ardhme të begatë përmes qasjeve moderne dhe përgjigjeve për të ardhme të dëshirueshme.

Revolucioni teknologjik, globalizimi, migrimi, degradimi i mjedisit, përmbyjsja e piramidës demografike në shoqëritë industriale, zgjerimi i Bashkimit Evropian dhe pasojat e tij, janë vetëm disa nga zhvillimet e rëndësishme socio-politike që me të madhe ndikojnë në të kuptuarit dhe zhvillimin e një qeverisje të qëndrueshme pjesëmarrëse të qytetarëve në Kosovë. Secili nga këta mekanizma socialë është shumë kompleks dhe ekzistojnë bashkëveprime të shumta dhe përzierje ndërsjella mes tyre. Ndonëse brezi i ri në Evropë mund të mendojë se mosangazhimi mund të jetë alternativa, besoj se secili prej nesh është vazhdimisht i kyçur në vendimet shoqërore dhe politike, dhe si e tillë kjo është çështje e domosdoshmërisë pse ne flasim për këto vendime, përmes dialogut dhe pjesëmarrjes aktive në caktimin dhe ndërtimin e pajtueshmërisë mbi prioritetet zhvillimore. Këta janë treguesit që na ndihmojnë në ushtrimin e 'parashikimeve': gjetjen e zgjidhjeve dhe ndërtimin e të ardhmes realiste dhe të begatë.

Gjetja e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova

Pleurat Halili

Ekspert për të zhvendosurit dhe refugjatët

Konfliktet në baza etnike në ish-republikat e Jugosllavisë kanë detyruar me mijëra civilë që t'i braktisin shtëpitë e tyre. Disa prej tyre kërkuar strehim në vendet e treta – kryesisht në Evropën perëndimore – dhe disa të tjerë mbetën si Persona të Zhvendosur Brenda Vendit (PZHBV) duke kërkuar mundësinë e ikjes brenda për brenda rajonit. Edhe pse kanë kaluar më shumë se tetë vite që kur ndodhën zhvendosjet e para, rreth 20,000 njerëz vazhdojnë të mbeten si persona të zhvendosur brenda Kosovës¹⁷ dhe rreth 200,000 syresh gjinden brenda territorit të Serbisë.

Që nga viti 2000, vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare është drejtuar në radhë të parë kah PZHBV-të që ktheheshin në Kosovë nga Serbia dhe Mali i Zi. Komuniteti i donatorëve përfshirë këtu OJQ-të së bashku me OJQ-të e tjera ka qenë kryesisht i interesuar në ofrimin e ndihmës për kthimin e organizuar pikërisht për këtë grup të veçantë.

Deri më tani, është vërejtur një interesim i ulët për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për PZHBV-të brenda Kosovës të cilët vazhdojnë të mbeten të harruar nga ana e organeve ndërkombëtare. Nevojtat e PZHBV-ve brenda Kosovës – në veçanti të atyre të cilët jetojnë nëpër qendra kolektive – shpesh janë të lëna pas dore. Grupet më të cënueshme vazhdojnë të mbeten komunitetet e romëve, të ashkalive dhe të egjiptianëve, të cilët rëndom jetojnë në kushte të këqija nëpër vendbanime informale dhe janë shpesh të izoluar nga pjesa tjetër e shoqërisë. Problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti RAE lidhen me diskriminim e vazhdueshëm me të cilin ky komunitet është përballur kudo në Ballkan. Perceptimet dhe klisjetë tradicionale shpesh kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi qasjen në shkollimin dhe arsimimin e tyre. Fëmijët e komunitetit RAE zakonisht nuk vazhdojnë arsimimin e tyre në shkollën e mesme dhe vetëm një numër shumë i vogël i tyre kryejnë shkollimin universitar, gjë e cila ndikon në krijimin e një rrethi vicioz të varfërisë dhe të përjashtimit nga shoqëria. Një situatë e këtillë shpesh i shpie pjesëtarët e këtij komuniteti që të jenë të varur nga të ardhurat që vijnë nga puna e fëmijëve si dhe nga kërkimi i lëmshës. Në këtë kuptim, është përgjegjësi

e autoriteteve vendore të Kosovës që t'i zhvillojnë politikat për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme sa i përket vendstrehimit të tyre si dhe për ngritjen e vetëdijes lidhur me rëndësinë e shkollimit dhe të arsimimit në veçanti të komunitetit RAE. Përveç kësaj, trajnimet profesionale poashtu do të kontribuonin në aftësimin e punëtorëve të shkathtë për tregun kosovar të punës.

Rreth 16,000 persona të zhvendosur tashmë janë kthyer në shtëpitë e tyre në Kosovë që nga viti 2000. Faji për këtë numër kaq të vogël të të kthyerëve krahasuar me numrin e përgjithshëm të supozuar të PZHBV-ve, mund t'u lihet disa arsyeve të cilat kanë vështirësuar deri më tani kthimin e qëndrueshëm. Së pari, ndjenja e mungesës së sigurisë si dhe mungesa e lirisë së lëvizjes vazhdojnë edhe më tutje të kenë ndikimin e tyre në marrjen e vendimit për t'u kthyer. Kur t'i shtohet kësaj edhe pasiguria lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës, atëherë del se edhe kjo arsye ka pasur ndikimin e vet tek PZHBV-të që të vazhdojnë të mbeten në Serbi dhe në Mal të Zi. Përveç këtyre arsyeve, shumë PZHBV e sidomos serbët e kanë shumë të vështirë apo mbase edhe të pamundur që të kthehen në shtëpitë dhe në komunitetet e tyre në Kosovë, ngase që nga shkuarja e tyre rrethanat shoqërore dhe ato ekonomike atje kanë ndryshuar në përmasa dramatike. Përfundimisht, zhvillimi ekonomik i Kosovës vazhdon jo vetëm që të pengojë kthimin por edhe që të inkurajojë edhe shumë të tjerë që ta braktisin Kosovën për një jetë me kushte më të mira në shtetet e BE-së.

Tashmë është bërë e qartë se programet e ndihmës, të pashoqëruara me ndihma të tjera vetëm sa i sjellin të kthyerit në një situatë të varshmërisë dhe asgjë më tepër. Ndihmat për mbajtjen e tyre në jetë duhet që gjithnjë të jenë të shoqëruara edhe me projekte të gjenerimit të të ardhurave që u mundësojnë përfituesëve që t'i zhvillojnë dhe t'i shfrytëzojnë aftësitë e tyre profesionale. Kthimi i qëndrueshëm si dhe reintegrimi varen në një shkallë të madhe nga mundësitë për sigurimin e jetesës, të cilat ekzistojnë në zonat e caktuara për kthim. Nëse zhvendosja ofron mundësi më të mira për të jetuar sesa vendi i kthimit, është krejt e kuptueshme se PZHBV-të do të vazhdojnë të mbeten në ato vende ku janë zhvendosur. Deri më tani, kthimi vullnetar i personave të zhvendosur nga Kosova ka qenë e vetmja zgjidhje e preferuar për UNHCR-në si dhe për qeveritë përkatëse. Me ndryshimin e statusit politik të Kosovës tash është e nevojshme që të rishikohet një qasje e tillë dhe që në vend të saj të zgjedhet zhvillimi i një strategjie vendore të reintegrimit të

¹⁷ Nga të cilët 45% janë shqiptarë të Kosovës të zhvendosur në pjesën jugore të rajonit të Mitrovicës.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

atyre PZHBV-ve, të cilët më nuk kanë dëshirë që të kthehen në shtëpitë e tyre. Gjatë shqyrtimit të problemeve që kanë të bëjnë me zhvendosjen, qeveritë përkatëse duhet që të sigurojnë zgjidhje afatgjatë të problemit të strehimit dhe të vendosjes, gjë e cila do ta lehtësonte mbylljen e qendrave kolektive. Përveç kësaj që u tha më lartë, qeveritë gjithashtu duhet që PZHBV-ve t'u ofrojnë ndihmë vetëmbështetëse, e cila është përgatitur me qëllim që t'u përshtatet nevojave dhe mundësive të tyre. Strategjitë për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për PZHBV-të nga Kosova përmes kthimit të tyre apo përmes integritit të tyre në vend, mund të jenë të suksesshme vetëm poqese në çfarëdo programi të ndihmave parashihet edhe ndihma domethënëse dhe e rëndësishme zhvillimore. Përveç strehimit të qëndrueshëm, është poashtu e nevojshme që të përfshihet edhe ndihma në të holla të gatshme si dhe skemat e mikro-kredive për ndërmarrësit pas kryerjes së trajnimeve profesionale.

Çfarëdo zgjidhje e qëndrueshme lidhur me çështjen e nevojave të PZHBV-ve duhet që të plotësohet me ndihmë zhvillimore. Reintegrimi i personave të kthyer apo integrimi vendor i PZHBV-ve ose i refugjatëve mund të ketë sukses vetëm poqese autoritetet përkatëse të ofrojnë jo vetëm infrastrukturën ligjore por poashtu edhe strategjitë gjithëpërfshirëse për t'u mundësuar PZHBV-ve që të bëhen të pavarur. Përveç izolimit shoqëror si dhe mungesës së mundësive për shkollim dhe arsimim, mundësitë e kufizuara për punësim në zonat e kthimit do të vazhdojnë pengimin e reintegrimit të qëndrueshëm si dhe vështirësimin e tij.

Zhvillimi Lokal për Stabilizimin e Komuniteteve në Mitrovicë dhe Zveçan, Kosovë¹⁸

Dr. Ricardo Pinto

Konsulent për Menaxhim nga, Stratagem Consulting International

Sfidat zhvillimore në Mitrovicë dhe Zveçan

Që nga konflikti i vitit 1999 Mitrovica ka qenë e ndarë nga lumi Ibër. Në jug pjesa dërmuese e popullsisë janë shqiptarë kosovarë. Pothuajse të gjitha nga 300 familjet e serbëve të Kosovës që jetonin në jug kanë kaluar në veri që tashmë është vendbanim i rreth 15,000 Serbëve të Kosovës, rreth 5,000 prej të cilëve janë Persona të Zh-

vendosur Brenda Kosovës (IDP). Para konfliktit, mbi 50 % e popullatës në veri të qytetit ishin shqiptarë të Kosovës; sot më pak se çereku i tyre kanë mbetur aty. Megjithatë, është e pamundur të sigurohen shifra të sakta për popullatën si për Mitrovicë ashtu edhe për Zveçan.

Numri i boshnjakëve në këtë zonë ka rënë me të madhe krahasuar me shifrat e para konfliktit prej 6,000 banorëve. Sot ky numër sillet prej 2,000 – 3,000 si në veri ashtu edhe në jug të lumit Ibër. Ka pasur edhe një pakësim të ngjashëm në komunitetin turk, me rreth 800 banorë që jetojnë në të dy anët e lumit. Popullata rome e para konfliktit (rreth 6,000) nga Mitrovica jugore janë zhvendosur në komunat veriore të Kosovës dhe në Serbi. Rreth 275 banorë jetojnë në një qendër kolektive në veri të qytetit dhe një numër i vogël i familjeve jetojnë në akomodime private në jug. Mbi 40 familje Hashkalinjesh kanë mbetur në jug të Mitrovicës, shumica e tyre të përqendruar në një bashkësi. Pjesëtarët e të gjitha bashkësive zotërojnë prona në të dy pjesët e qytetit dhe kanë bërë përpjekje të pareshtura për t'i kthyer ato në pronësi.

Mungesa e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes është një pengesë serioze për krijimin e jetës normale në zonën e Mitrovicës. Ndarja e qytetit po ashtu ka komplikuar ofrimin e shërbimeve publike, dhe në fakt ka çuar te krijimi i shërbimeve të ndara për veri dhe jug. Komunat e Mitrovicës dhe Zveçanit përballen me sfida të shumta. Njëherë një zonë e identifikuar me një kompani (Minierat e Trepçës), komunat tash janë të de-industrializuara dhe të ndara. Në këtë zonë ekziston shkallë e lartë e papunësisë, ndotjes, mungesës së zhvillimit rural, një sektor privat i vogël dhe i pazhvilluar, një popullatë e re dhe relativisht e pakualifikuar, infrastrukturë shumë joadekuatë me një strukturë të komplikuar administrative. Sfidat kryesore zhvillimore është të gjendet një orientim i ri për qytetin, të eliminohen ndasitë, të përmirësohet gjendja e sigurisë, të lehtësohen kthimet dhe të zhvillohet ekonomia. Ekzistojnë përpjekje si nga bashkësia vendore ashtu edhe ajo ndërkombëtare për të përmirësuar situatën. Ky ishte rasti sidomos pas trazirave të marsit 2004, të cilat filluan në Mitrovicë dhe u shtrinë në mbarë Kosovën dhe që çuan te vdekja e 19 personave dhe lëndimi i mbi 800 të tjerëve.

Megjithatë, njoftimi i bërë në shkurt të vitit nga z. Maarti Ahtisaari (i Dërguar Special për Kosovë) në lidhje me Zgjidhjen për Kosovën ofron një perspektivë për krijimin e një dinamike të re si në Mitrovicë ashtu edhe në Zveçan.

¹⁸ Ky artikull bazohet në materialet në vazhdim të UNDP: "Zhvillimi Lokal për Stabilizimin e Komuniteteve" (Ann Hyde and Aleksandar Gvozdic, 2007), "Administrata Publike në Sektorët e Arsimit dhe Shëndetësisë" (Richard Kobayashi dhe Luan Bicaj, 2007) dhe "Zhvillimi Ekonomik në Mitrovicë dhe Zveçan" (Ricardo Pinto dhe Ervin Dervisevic, 2007)

Disa nga sfidat kryesore të zhvillimit ekonomik me të cilat përballet kjo zonë shqyrtohen në vijim:

Arsimi

Sfida kryesore në sektorin e arsimit është të sigurohet:

- Përmirësimi i infrastrukturës, pajisjeve, transportit, mjedisit të përgjithshëm shkollor përfshirë sigurinë nga zjarri dhe përmirësimet sanitare.
- Avancimin e shkathësive menaxhuese dhe teknike.
- Avancim profesional i mësimdhënësve.
- Këmbim përvojash mes institucioneve arsimore në Kosovë dhe jashtë Kosove.
- Sigurimin e teksteve shkollore të reja dhe të përmirësuara që janë të relevante për nevojat aktuale.

Një varg faktorësh, sidomos të ndërlidhura me lëvizjen e popullatës për shkak të luftës, kanë rezultuar në rritjen e regjistrimeve si në jug ashtu edhe në veri, duke ushtruar trysni të madhe si te mësimdhënësit ashtu edhe te objektet. Sektori i arsimit nuk është i furnizuar si duhet dhe shumë objekte ekzistuese janë në gjendje të keqe. Mësimdhënësit dhe kuadri udhëheqës kanë mundësi të kufizuara për trajnime formale dhe këmbime joformale me kolegët e tjerë profesionalë. Përkundër përpjekjeve nga ana e serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës në sferat e tyre përkatëse, sektori i arsimit në Kosovë është në rënie e sipër. Kjo gjendje mund të zbutet dhe të përmirësohet përmes një qasjeje që zhvillon një zgjedhje të bazuar në komunitet për arsimin dhe që rrit kapacitetin e mësimdhënësve, administratorëve dhe politikanëve lokalë për t'u angazhuar për siguruar përkrahje të duhur nga autoritetet qendrore. Mund të thuhet se kushtet për shkollim në jug janë shumë më të këqija, por fakti mbetet se në të dyja anët e lumit, të dy sistemet kanë nevojë për intervenime domethënëse nëse të rinjtë zhvillojnë shkathësitë e nevojshme për të siguruar jetesë.

Shëndetësia

Ndarja veri/jug në të vërtetë ka eliminuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes sektorëve të shëndetësisë publike në të dyja anët e lumit Ibër. Aktualisht nuk ekziston kurrfarë kontakti mes doktorëve si në të kaluarën. Përveç kuadrit dhe pagave, shumë vështirësi me të cilat përballet shëndetësia primare në Mitrovicën jugore dhe veriore dhe në Zveçan janë të njëjta. Sfidat kryesore për përmirësim ngërthejnë në vete:

- Përmirësime në infrastrukturë, objekte dhe pajisje.
- Planifikime strategjike, implementim, menaxhim, sigurim të fondeve dhe ndarje të buxhetit.
- Ngritje profesionale të kuadrit.
- Këmbim të përvojave mes institucioneve shëndetësore në Mitrovicën jugore/veriore dhe Zveçanit me institucioneve jashtë Kosovës, të rajonit ose të Kosovës.
- Menaxhim të shërbimeve.
- Avancim të shërbimeve për transportimin e pacientëve.

Si në jug ashtu edhe në veri, personeli shëndetësor nuk ka qasje në trajnime të rregullta për menaxhim dhe/ose shkathtësi klinike. Nuk ekziston ndonjë sistem i vazhdimësisë së shkollimit, sidomos në menaxhimin e sistemit shëndetësor. Ngritja e kapaciteteve në këtë fushë do të jetë qenësore nëse sistemet shëndetësore synojnë të përmirësojnë kualitetin dhe mundësinë për t'u përgjigjur në nevojat e popullatës. Një qasje që mobilizon mjekët, menaxherët dhe qytetarët ka më shumë të ngjarë të krijojë modele të qëndrueshme për ndryshime. Për më tepër, një klimë më e mirë politike është e nevojshme që sistemet shëndetësore në veri dhe jug të përmirësohen. Duke supozuar se do të ketë zgjedhje të reja me implementimin e Statusit Përfundimtar, kjo mund të bëhet realitet.

Shoqëria Civile & Pakicat

Donatorët ndërkombëtarë kanë investuar në projekte që përqendrohen në paqe, pajtim dhe ofrimin e formave të ndryshme të ndihmës humanitare. Madje edhe në projektet me një përqendrim në sektorë, agjenda e donatorëve ndërkombëtarë ka kërkuar qasje shumetnike për implementim, gjë që në Mitrovicë është dëshmuar të jetë e vështirë jetësohet dhe të jetë e qëndrueshme. Organizatat Jo-qeveritare (OJQ) aktive po punojnë me të madhe si shoqata profesionale, pa zgjedhës të anëtarësisë, komunitetit ose sektorëve.

Natyrë a lartë e shtytjes nga donatorët e sektorit të OJQ nënkupton se ato janë ngushtë të lidhura me qëllimet e donatorit dhe deri më tash kanë dështuar t'i kushtojnë vëmendje serioze krijimit të një deklarimi të qartë të misionit të tyre, rolit, qëllimit dhe strategjisë së tyre për organizim si brenda Mitrovicës ose më gjerë në Kosovë. Si pasojë, ekzistojnë lidhje të mangëta mes aktiviteteve të OJQ-ve dhe çështjeve urgjente për kualitetin e jetës si mungesa e ujit, rrymës, shkollimit joadekuat ose papunësisë që të gjitha ndikojnë në jetët e individëve nga të gjitha bashkësitë në të anët e Mitrovicës. Korniza institu-

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

cionale dhe qëllimi për komunitetet i shumicës së organizatave është e dobët dhe ka nevojë për zhvillime serioze organizative për të siguruar se ata vlerësojnë vendin e tyre brenda komunitetit si dhe brenda sektorit të caktuar dhe brenda Kosovës.

Ekziston një shtrëngesave që kufizojnë rritjen dhe mundësitë zhvillimore të sektorit përfshirë: mungesën e lokaleve me çmime që mund të paguhen, një rrjedhë e paqëndrueshme e fondeve në këtë sektor, mungesa e qartësisë dhe drejtimit për organizatat individuale, mungesa e lirisë së lëvizjes, mungesa e specializimit dhe kapaciteteve, mungesa e kuptimit të qartë për situatën në Mitrovicë nga shumë donatorë e kështu me radhë. Në përgjithësi, roli i sektorit të OJQ-ve – si një instrument i komunitetit, nuk kuptohet. Përtej agjendës së donatorëve, OJQ-të e kanë të qartë as rolin e tyre në raport me komunitetin ose si dhe ku duhet të kenë vendin brenda komunës. Për më tepër, komunat po ashtu kanë zhvilluar një kuptim të qartë për shoqërinë civile si një partner operacional, përtej rolit të angazhimit të qytetarëve.

Zhvillimi Ekonomik

Gjendja ekonomike ndikohet nga gjendja e përgjithshme politike në këtë zonë. Karakteristika kryesore e qytetit është ndarja e tij. Kjo krijon dy tregje të ndryshme me Mitrovicën jugore që funksionin si pjesë e tregut të punës së Kosovës, përderisa Mitrovica veriore dhe Zveçani funksionojnë me efikasitet si një treg i integruar, kryesisht i ndërlidhur me komunat e banuara me serbë të Kosovës, Leposaviq, Zubin Potok dhe Serbi.

Zhvillimi ekonomik dhe rrita në Kosovë janë ndikuar me të madhe nga shpërbërja e ndërmarrjeve të mëdha shoqërore (NSH). Kjo është edhe më e theksuar në rastin e Mitrovicës dhe Zveçanit duke pasur parasysh nivelin e varësisë nga konglomerati i minierave të Trepçës. (7,000 vende pune në vitin 1989). Sot, kompleksi Trepça thuhet nuk është fare operacional, duke punësuar vetëm një numër të kufizuar të njerëzve në Mitrovicë dhe Zveçan, shpesh me orar të pjesshëm. Sektori i NSH në Mitrovicën jugore pothuajse ka pushuar të jetë burim i të hyrave përveç disa qindra punëve të mirëmbajtjes që financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. NSH e tjera në Mitrovicën jugore janë në privatizim e sipër dhe ristrukturimi dhe largimi i prituri i punëtorëve do të kenë efekte serioze. Meqë vetëm një numër i vogël i njerëzve janë të punësuar në shërbimet publike, mundësia për të absorbuar tepërcën e punëtorëve është e kufizuar.

Shkalla e papunësisë në Mitrovicë dhe Zveçan është mbi 50 %, ndonëse këto vlerësime nuk janë të besueshme për shkak të ekzistencës së "strukturave paralele" serbe në zonat me shumicë të banorëve serbë të Kosovës. Shumë serbë të Kosovës të papunë nuk janë të regjistruar te strukturat e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), por mund të jenë regjistruar në byronë serbe për punësim në veri të Mitrovicës. Sipas të dhënave zyrtare, kishte 25,832 persona të papunë në Mitrovicë dhe Zveçan në dhjetor të vitit 2006. Ekonomia joformale njihet të jetë e gjerë.

Zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës në Mitrovicën jugore varen nga ndërmarrësit privat dhe iniciativat e tyre. Megjithatë, shumica e ndërmarrjeve janë të biznese familjare të shkallës së vogël, shumica e tyre duke luftuar të mbijetojnë. Probleme të shumta për bizneset në Mitrovicën jugore përfshijnë furnizimin me ujë e rrymë, qasje në financa dhe njohuri.

Mitrovica veriore dhe Zveçani mbështeten me të madhe në subvencionet me para të thata nga qeveritë e Serbisë dhe Kosovës, UNMIK-u dhe organizatat ndërkombëtare (donatorë, Institucione Financiare Ndërkombëtare (IFI), OJQ-të, etj.) që operojnë në këtë zonë. Shumica e njerëzve janë të punësuar në institucionet e IPVQ-ve dhe/ose administratën serbe dhe varen ose nga buxheti i Serbisë ose i Kosovës. Heqja e secilit nga këto burimeve do të kishte pasoja të rënda për popullatën e kësaj zone.

Zhvillimi Lokal dhe Stabilizimi i Komunitetit

UNDP ka implementuar projekte në rajonin e Mitrovicës që përqendrohen në çështje si ato të zhvillimit socio-ekonomik, përfshirje të pakicave dhe zhvillim rajonal. Siç ilustron në analizat paraprake, tash ka ardhur koha për një program gjithëpërfshirës që do të trajtonte një varg të gjerë çështjesh në Mitrovicë. Sfidat kryesore me të cilat përballen Mitrovica dhe Zveçani mund më së miri të trajtohen përmes një programi mbështetës shumë-sektorial dhe shumëvjeçar të modeluar për të zbutur varfërinë dhe prapambetjen socio-ekonomike, e që përqendrohet në ofrim më të mirë të shërbimeve kyçe komunale.

UNDP ka formuluar një projekt që pasqyron karakteristikat unike të Mitrovicës dhe Zveçanit dhe që bazohet në hulumtimet e hollësishme që vlerësojnë nevojat dhe në analizimin e natyrës së politikave ekzistuese, institucioneve dhe burimeve, po ashtu duke marrë parasysh njoftimin e Statusit Përfundimtar të Kosovës në shkurt të vitit 2007. Projekti lokal për zhvillim të qëndrueshëm përqendrohet në pesë komponenta të diskutuara më lart: së pari

ai do të kërkojë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, që konsiderohen si kritike, për më tepër kushtet për zhvillimin e shoqërisë civile do të përmirësohen, kryesisht përmes mbështetjes për zhvillimin e rrjeteve të organizatave lokale, OJQ-ve dhe grupeve të qytetarëve. Procesi po ashtu do të kërkojë të krijojë kushtet për integrimin e pakicave dhe për uljen e tensioneve ekzistuese ndëretnike. Në fund, projekti synon të krijojë kushte që nxisin zhvillimin e sektorit privat dhe hapjen e vendeve të punës përmes mbështetjes së shërbimeve për zhvillime afariste, punë të ndërmjetme/publike dhe mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Harmonizimi i Legjislaturës me Acquis Communautaire dhe Kosova

Nga Av. Jordan DACI,

Këshilltar, Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar dhe Ekonomik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Harmonizimi i legjislaturës me Acquis Communautaire paraqet një nga sfidat kryesore për shtetet candidate për anëtarësim në BE, duke përfshirë ato që aspirojnë t'i bashkohen BE-së në vitet që po vijnë apo të ashtuquajturat vendet e Ballkanit perëndimor. Në anën tjetër, harmonizimi i legjislaturës është një nga tri kriteret kryesore për anëtarësim në BE apo të ashtuquajtuat Kriteret e Kopenhagës (1993). Në qershor të vitit 2003, në samitin e Selanikut prapë u rikonfirmua perspektiva e anëtarësimit në BE e shteteve të Ballkanit perëndimor, duke përfshirë Kosovën. Megjithatë, status i pazgjidhur i Kosovës mbetet një nga pengesat kryesore që në një mënyrë e parandalon avancimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe BE-së dhe krijon vështirësi shtesë lidhur me harmonizimin e legjislaturës me Acquis communautaire. Termi Acquis communautaire, është përdorur për herë të parë në një mendim të Komisionit të BE-së të 1 tetorit 1969, përkthimi me parashtrimin e kërkesës për anëtarësim nga Britania e Madhe, Danimarka, Irlanda dhe Norvegjia. Ky term në mënyrë më të qartë është përdorur në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian, të njohur gjithashtu si Traktati i Mاستrihtit. Thënë më thjesht, Acquis communautaire do të thotë rregullat që e formojnë kornizën ligjore funksionale të Komunitetit Evropian.

Në fakt, shikuar nga aspekti juridik, procesi i harmonizimit të legjislacionit me Acquis Communautaire nuk paraqet obligim ligjor *de jure* për Kosovën për sa kohë që

ajo nuk është anëtare e BE-së dhe nuk ka marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian. Megjithatë, cikli i tanishëm i miratimit të ligjeve dhe të akteve nënligjore kërkon vërtetimin e përputhshmërisë së tyre me Acquis Communautaire. Dokumenti i vërtetimit lëshohet nga Agjencia për integritet evropian dhe nga Zyra e kryeministrit.

Harmonizimi i legjislaturës me Acquis communautaire, në mes të tjerash, do të thotë miratimin e normave juridike të Acquis communautaire në legjislaturën e vendit. Miratimi nuk nënkupton procesin mekanik, me fjalë të tjera nuk është një përafrim tekstual i tekstit ligjor, por një përafrim standardesh. Ekzistojnë tri lloje të harmonizimit: a. harmonizim i plotë; b. harmonizimi i pjesshëm; c. harmonizimi nuk aplikohet. Forma e tretë është e vlefshme për çështjet që nuk hyjnë nën juridiksionin e institucioneve të BE-së, ndërsa forma e dytë i përfshinë çështjet që pjesërisht hyjnë nën juridiksionin e institucioneve BE-së.

Njëkohësisht me procesin e harmonizimit, të gjitha vendet candidate duhet të përkthejnë në gjuhët e tyre shtetërore të Acquis communautaire, e cila përafërsisht i ka 95.500 – 105.000 faqe. Përkthimi është parakusht për anëtarësim në BE, dhe vendet duhet që vet t'i paguajnë shpenzimet e përkthimit. Për shembull, për vitin 2005 Kroacia ka shpenzuar 1 milion euro, ndërsa IRJM-ja¹⁹ - rreth 360 mijë euro. Metodologjia e përkthimit ngërthen krijimin e Njësisë për Përkthim dhe Bashkërendim (NJPB) dhe gjithashtu parashihet përkthime që bëhen jashtë kësaj Njësie. Pas përkthimit, teksti revidohet nga ekspertët gjuhësor dhe nga juristët me njohuri të gjuhëve të huaja, si dhe më pastaj futet në bazën e të dhënave të dhënës nga TAIEX –i dhe i komunikohet Komisionit të BE-së.

Mirëpo në rastin e Kosovës ekziston mundësia e zvogëlim-it të dukshëm të shpenzimeve të përkthimit përmes një marrëveshjeje të mundshme mes Kosovës, IRJM-së dhe Shqipërisë. Në bazë të Marrëveshjes së Ohrit, IRJM-ja është po ashtu e obliguar që ta përkthejë Acquis communautaire në gjuhën maqedone dhe në atë shqipe. Përveç kësaj marrëveshjeje, Kosova, IRJM-ja dhe Shqipëria filimisht duhet të hartojnë një fjalorth të përbashkët që do të njësoj të kuptuarit juridik të termeve. Gjithashtu nuk duhet të harrojmë se në bazë të propozimit të Ahtisarit, serbishtja është po ashtu gjuhë zyrtare në Kosovë. Andaj, Kosova duhet të shqyrtojë gjithashtu arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë lidhur me përkthimin e Acquis communautaire në gjuhën serbe.

¹⁹ Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

Burimet e Acquis communautaire janë:

- Aktet ligjore;
- Aktet nënligjore;
- Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Gjykata e Instancës së Parë dhe
- Kurset e tjera.

Legjislatura parësore përfshinë: a. traktatet e BE-së dhe të Komunitetit, b. marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Komuniteti me palët e treta; c. marrëveshjet e stabilizim-asocimit (baza e tyre ligjore është në nenin 310 të Traktatit të Komunitetit Evropian (ish-neni nr. 238)). Në ndërkohë burimet e akteve nënligjore janë të përcaktuara në nenin 249 të Traktatit të Komunitetit Evropian, të cilat përfshijnë: a. rregulloret; b. direktivat; c. udhëzimet; d. rekomandimet dhe mendimet. Burimet e tjera përfshijnë: aktet e miratuara nga përfaqësuesit e shteteve anëtare në takimet e Këshillit, parimet e përgjithshme të së drejtës, parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe legjislaturën e vendit të shteteve anëtare.

Përvojat e shteteve të tjera kandidate kanë treguar se ky proces është shumë i vështirë dhe se kërkon një administratë publike me kualifikime të larta dhe një strategji të mirë kombëtare, duke përfshirë përkrahjen e duhur financiare. Në rastin e Kosovës procesi i harmonizimit paraqet një sfidë reale për administratën e re të Kosovës për shkak të mungesës së përvojës, mungesës së resurseve të kualifikuara njerëzore dhe mungesës së përkrahjes financiare. Andaj, për ta përgatitur në mënyrë të suksesshme vetën për fillimin dhe përfundimin e procesit të harmonizimit, Kosova duhet që menjëherë të rishikoj kornizën ekzistuese ligjore për shërbimin civil për të krijuar një bazë të qëndrueshme për ngritjen e kapaciteteve dhe për të bërë administratën publike tërheqëse, si dhe njëkohësisht të qasshme për të diplomuarit e universiteteve të jashtme.

Ky është moment i duhur që Kosova t'ia filloj dhe të kryej me sukses një rivlerësim të hollësishëm të sistemit të tanishëm të shërbimit civil për të qenë e përgatitur paraprakisht për sfidën e procesit të harmonizimit dhe për proceset e tjera të ndërvarura dhe të ndërlidhura. Populli i Kosovës do të kuptojë se integrimet evropiane ofrojnë kornizën për zhvillimin e përbashkët të të gjitha komuniteteve në Kosovë, si dhe të vendeve në regjion si mënyrë e tejkalimit të konflikteve nga e kaluara dhe të atyre të tanishme. Në këtë aspekt, procesi i harmonizimit të legjislaturës me Acquis communautaire është njëra mënyrë e bashkëpunimit në Ballkanin perëndimor.

Kosova, Procesi i statusit përfundimtar dhe sfidat e zhvillimit

Dardan Velija

Këshilltar i Kryeministrit të Kosovës

Një proces për të përfunduar një proces tjetër

Në shkurt të vitit 2006, Kryetari Marti Ahtisaari mori përsipër detyrën për të negociuar procesin e zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës. Procesi tani është në fazën e tij të fundit dhe Kryetari Ahtisari ka hartuar një dokument i cili ofron bazë të mirë për shtetin e ardhshëm të Kosovës, i cili garanton rrugën e tij drejt integritimit euroatlantik, të bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe në të drejtat më të gjëra për pakicat.

Duket qartë se me zgjidhjen e statusit të Kosovës do të përfitojë i tërë rajoni në aspektin ekonomik, politik por edhe në atë të sigurisë. Këto janë parakushte për zhvillim. Për momentin është e qartë se statusi kuoja e tanishme nuk është qëndrueshme dhe se kërkohet një dinamikë e re në mënyrë që të shtohen mundësitë e Kosovës dhe mbarë rajonit që të zënë hapin me pjesën tjetër të Evropës.

Bashkësia ndërkombëtare e ka kuptuar se nëse dëshirohet që procesi i demokratizimit dhe ndërtimit të institucioneve në Kosovë të ketë sukses, përgjegjësia për procesin duhet të kalojë te vet populli i Kosovës.

Kosova ka arritur një progres të jashtëzakonshëm në shumë fusha gjatë këtyre viteve të fundit. Ne tani e kemi organizimin institucional që kërkohet për tu bërë anëtar plotësisht funksional i bashkësisë ndërkombëtare. Për më tepër, kemi një sistem të shëndosë makroekonomik, një bazë të gjerë tatimore dhe një sistem legjislativ modern që mbron pronën private dhe investitorët privat, si dhe kemi një treg fleksibil të punës. Në të vërtetë, Kosova ka një ndër mekanizmat më të thjeshtë në rajon për regjistrimin e ndërmarrjeve.

Kosova ka ndryshuar shumë që prej intervenimit ndërkombëtar në vitin 1999. Standardi jetësor dhe liritë janë përmirësuar për të gjithë qytetarët dhe ne jemi duke ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të ofruar garanci për pakicat dhe për t'i siguruar ato se këto përmirësime janë universale për të gjithë banorët e Kosovës. Paketa e Ahtisarit siguron që komunat serbe të kontrollojnë shkollat dhe spitalet e tyre. Gjuha serbe do të jetë njëra ndër gjuhët zyrtare dhe qeveria e Kosovës do të garantojë edhe më tej përfaqësimin e pakicave në strukturat e qeverisë. Ne

shpresojmë që serbët e Kosovës të kuptojnë se vendi dhe e ardhmja e tyre është në Kosovë dhe se ne jemi të përkushtuar që të ruajmë karakterin multi-etnik të vendit tonë.

Qasje e "3E"-ve

Qeveria e Kosovës ka ardhur në përfundim se gjendja ekonomike e vendit duhet përmirësuar sa më parë që të jetë e mundur. Ne duhet të identifikojmë fushat me prioritet dhe me përparësi krahasuese ku investimi më i vogël do të sjell përfitimin më të madh. Sipas Qeverisë së Kosovës, investimi në rini është edhe prioritet por edhe përparësi krahasuese. Sidoqoftë, ne kemi identifikuar tri fusha që kërkojnë veprim të menjëhershëm, e ato janë Ekonomia, Energjia dhe Edukimi (Arsimi).

Vitin e kaluar Qeveria e Kosovës e fillojë procesin e hartimit të Strategjisë dhe Planit Zhvillimor të Kosovës (SPZHK), për të përcaktuar vizionin e përgjithshëm për zhvillimin e vendit. Ky mekanizëm do të na fus neve brenda Dokumentit Evropian për Politikën e Hyrjes në BE, përmes të cilës do të kanalizohet ndihma e Bashkimit Evropian (BE) për plotësimin e nevojave më të ngutshme.

Prioritetet e përcaktuara nga SPZHK-ja do të pasqyrohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe brenda Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve por poashtu do të jetë edhe dokument udhëzues për konferencën e donatorëve e paraparë të mbahet pas statusit.

Për shumë vite Kosova ka pasur probleme me energji elektrike. Energjia është identifikuar si prioritet jo vetëm për plotësimin e nevojave vetanake por edhe për shfrytëzimin e rezervave të thëngjillit në Kosovë, të cilat zënë vendin e pestë në mesin e rezervave më të mëdha të linjitet në botë. Kosova së shpejti do të ketë një projekt për energjinë në vlerë prej 2,3 miliardë eurosh, i cili do të sigurojë zhvillim të shpejtë ekonomik, do të plotësojë nevojat tona për energji si dhe do të bëjë të mundur eksportimin e energjisë në vendet fqinje.

Gjysma e popullsisë së Kosovës është nën moshën 30 vjeçare. Ne duhet tu ofrojmë këtyre evropianëve të rinj dhe dinamik qasje në arsim cilësor në mënyrë që të përgatisim ata për tu ballafaquar me sfidat e botës moderne dhe të globalizuar. Si këmbim, ata do të bëjnë gjëra të mëdha për Kosovën. Sistemi arsimor në Kosovë ka pësuar shumë gjatë politikës së diskriminimit dhe shpërfilljes. Përveç rritjes së buxhetit për arsimin, qeveria ka kërkuar nga BE-ja dhe nga qeveritë perëndimore që të ndihmojnë në këtë aspekt, dhe deri diku ka pasur sukses. Është e qartë se kjo është një fushë ku duhet të angazhohemi më shumë.

Kosova pas statusit

Pavarësia që e kemi dëshiruar për një kohë të gjatë do të vijë bashkë me përgjegjësitë, për të cilat jemi plotësisht të vetëdijshëm. Padyshim, pavarësia do të sjell atë qartësinë aq të nevojshme dhe orientimin drejt së ardhmes, por ajo nuk do të zgjidh të gjitha problemet e Kosovës. Neve do të na duhet të përqëndrohemi në zhvillimin ekonomik, reformat politike, bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian. Vendimi për statusin pritet të ndikojë në ekonominë e Kosovës. Tërheqja e UNMIK-ut mund të ketë ndikim negativ në ekonomi. Sidoqoftë, pasi të largohet UNMIK-u, Kosova do të ketë mundësi të marrë hua, gjë që është hap i rëndësishëm drejt realizimit të aktivitetit të nevojshëm makroekonomik i cili garanton zhvillim afatgjatë.

Aktualisht, ne kemi një shkallë shumë të lartë të papunësisë. Çdo vit tregut të punës i shtohen rreth 28,000 të rinj. Sfidat janë kryesore do të jetë rritja e shkallës së zhvillimit ekonomik, e cila pastaj do të krijojë vende të reja pune. Tashmë janë krijuar kushte të mira për investime përmes themelimit të sistemit të ekonomisë liberale me një ekonomi konkurruese të tregut. Ne tani jemi pjesë e Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), e cila i ka siguruar Kosovës qasje në tregun e madh të Evropës Juglindore. Përveç kësaj, Kosova poashtu gëzon një nivel të autonomisë tregtare e cila na mundëson që të eksportojmë edhe në vendet e BE-së. Të gjitha këto masa ka mundësi që të kenë ndikim pozitiv në Kosovën e pas statusit.

Bashkësia ndërkombëtare është angazhuar në ndërtimin e një Kosove të re pothuaj nga zeroja. Tani ne kemi të gjitha mundësitë institucionale që na mundësojnë të punojmë si duhet. Por prapëseprapë, përmirësimi i efikasitetit dhe efektshmërisë së institucioneve tona është një sfidë e cila do të duhet të trajtohet.

Ne kemi identifikuar integrimin rajonal jo si një mekanizëm të imponuar për të siguruar paqen por si një zhvillim pozitiv që na mundëson të jemi ekonomikisht konkurrues dhe që të sigurojmë stabilitet në këtë pjesë të kontinentit. Siç u tha më herët, ne jemi plotësisht të angazhuar në procesin e krijimit të një zone të tregtisë së lirë dhe në të gjitha aktivitetet tjera rajonale në të cilat kemi të drejtë të marrim pjesë. Ne e kuptojmë se sa më të mira që i kemi marrëdhëniet me fqinjët tonë aq më të mëdha janë mundësitë që Kosova të tërheq investime të huaja direkte, si dhe të ruajë stabilitetin e rajonit dhe të përshpejtojë procesin e integritit evropian. Të gjitha çështjet nga e kaluara duhet të trajtohen nga kjo perspektivë veçanërisht kur khet parasysht se marrëdhëniet e mira janë në të mirë të secilit vend si dhe në të mirë të të gjithë rajonit.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

Aspiratat e integritit në BE padyshim kanë qënë forca kryesore shtytëse për reformat në Evropën Qendrore dhe Lindore. Evropa Juglindore tani është e rrethuar nga Bashkimi Evropian dhe kjo e bën të pashmangshëm integritin në BE. Për qeverinë e Kosovës, kjo perspektivë për zhvillim, paqe dhe stabilitet në rajonin tonë dhe për forcimin e identitetit tonë evropian do na bëjë të punojmë për arritjen e integritit sa më të shpejt. Kosova është tani pjesë e Mekanizmit Përcjellës të Stabilizimit dhe Asociimit, një instrument i përshtatur në mënyrë të veçantë për vendet që duan të anëtarësohen në BE. Ne synojmë të arrijmë Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit sa më shpejt që të jetë e mundur pas finalizimit të procesit të statusit. Çështja më urgjente tani është lëvizja e lirë e njerëzve në rajonin tonë dhe në përgjithësi në Evropë. Ne shpresojmë se BE-ja do të kuptojë urgjencën e kësaj çështjeje, e cila tani është duke kërcënuar zhvillimin tonë ekonomik dhe shoqëror.

Ne i kuptojmë mirë të gjitha sfidat me të cilat ballfaqohemi, por nuk ka hapësirë për dekurajim. Përvoja e fqinjve tonë që tani janë anëtarë të BE-së na tregojnë se përmirësimi i sundimit të ligjit, forcimi i aftësisë së sigurisë dhe luftimi i korrupsionit janë sfida që mund të arrihen me një vullnet të mirë politik. Ka shumë fusha me të cilat mund të krenohemi, siç është Shërbimi Policor i Kosovës i cili është shumë profesional.

Dikush mund të thotë se ka pasur ndryshime të mëdha prej viteve 1990-ta. Por tranzicioni para nesh do të jetë edhe më sfidues. Qeveria e Kosovës do të marrë përgjegjësinë e plotë në të gjithë sektorët, me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë. Tejkalimi i sfidave nuk do të jetë gjithmonë i lehtë, por sfida jonë më e madhe do të jetë shfrytëzimi i mundësive që do të krijohen pasi Kosova të jetë bërë një shtet i ri evropian.



United Nations
Payton Place 14,
10000 Pristina, Kosovo

Tel: ++381 38 249 066
Fax: ++381 38 249 065
www.ks.undp.org